



10.11.2022

## PUNIMI PËRFUNDIMTAR

*Takim kombëtar në shkallë të vogël i RNR në Ballkanin Perëndimor  
17-18 tetor 2022, Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë*

# Përkrahja e familjeve të lëna pas

## Rezultatet kryesore

Duke u mbështetur në përvojat personale të fituara në rehabilitimin, veçanërisht të grave dhe fëmijëve që kthehen nga zonat e dikurshme të kontrolluara nga DAESH-i në Siri dhe Irak, qeveria e Bosnjë dhe Hercegovinës (BdheH) ka miratuar një strategji të re kombëtare kundër terrorizmit (2021-2026). Kjo strategji synon të promovojë një qasje të bashkënduar për përgatitjen e familjeve dhe komuniteteve pranuese të grave dhe fëmijëve që ka të ngjarë të riatdhesohen në një moment në të ardhmen<sup>1</sup>. Është parashikuar që programet dhe aktivitetet e riintegritimit, rehabilitimit dhe risocializimit të përmbajnë masa afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata në fushën e sigurisë, shëndetësisë dhe mbrojtjes sociale, aksesit në arsim, masa për mbështetje ekonomike dhe punësim, ndihmë juridike, si dhe masa të tjera të nevojshme si në mjediset e kujdestarisë, ashtu edhe në ato jokujdestare. Programet do të përfshijnë edhe familjet e të kthyerve si përfitues, në mënyrë që të përgatiten për kthimin eventual të anëtarëve të familjeve të tyre.<sup>2</sup>

Për të shkëmbyer njohuri dhe përvoja, për të forcuar kompetencat dhe për të zhvilluar një kuptim të asaj që kërkohet për të adresuar nevojat dhe rreziqet që lidhen me riatdhesimet e ardhshme, në një seminar dy-ditor të ekspertëve u mblodhën së bashku punonjës socialë, psikologë dhe administratorë lokalë nga BdheH, Kosova\*, Serbia dhe Finlanda të cilët punojnë në fushën e P/KEDH në lidhje me mbështetjen e të kthyerve dhe familjeve të tyre. Vështrimet kryesore të nxjerra nga takimi janë dhënë më poshtë:

- Familjeve të personave që u larguan për në Siri dhe Irak shpesh u mungon mbështetja e nevojshme për të përballuar konfuzionin dhe stresin që lidhet me largimin dhe mungesën e të afërmeve të tyre. Ato kërkojnë mbështetje nga punonjësit socialë në nivel lokal në mënyrë që të ndërtojnë kapacitetet e tyre për të punuar me të kthyerit dhe fëmijët e tyre.
- Për të mbështetur familjet e lëna pas, praktikuesit duhet të përshtasin qasjet për secilën familje. Mbështetja e kërkuar varet nga disa çështje, si p.sh. nëse anëtari i familjes që është larguar për në Siri ose Irak është ende gjallë apo jo apo nëse ka edhe fëmijë të përfshirë. Në rastet kur ka vdekur ndonjë anëtar i familjes, nevojitet mbështetje për të pikëlluarit.

<sup>1</sup> Për më tepër, BdheH miratoi një plan dhe program riatdhesimi për riintegrimin, rehabilitimin dhe risocializimin e shtetasve të kthyer të Bosnjë dhe Hercegovinës nga zonat e konfliktit në Siri dhe Irak. Ato ofrojnë hapa të detajuar për çdo institucion të përfshirë në rehabilitim dhe riintegrim, duke i detajuar procedurat për një kthim të sigurt, njerëzor dhe të kontrolluar të shtetasve të BdheH nga Siria dhe Iraku.

<sup>2</sup> Strategjia e Bosnjës dhe Hercegovinës për Parandalimin dhe Luftën Kundër Terrorizmit (2021-2026)

Ky kategorizim është pa paragjykim për pozitat lidhur me statusin, dhe është në përputhje me UNSC 1244 dhe Mendimin e GJND (Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë)  
Deklarata e Pavarësisë së Kosovës

- Aktorët e shoqërisë civile mund të veprojnë si urë lidhëse ndërmjet familjeve dhe institucioneve, me qëllim që të ndërtojnë besimin dhe të punojnë së bashku drejt rehabilitimit dhe riintegrit të kthyerve.
- Vendet e BE-së mund të mësojnë nga praktikuesit e Ballkanit Perëndimor kur bëhet fjalë për punën me gratë dhe fëmijët e kthyer, veçanërisht në rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre në komunitetet lokale.

## Çështjet kyçe të diskutimit

Çështjet kyçe të diskutimit të mbajtur në Sarajevë janë paraqitur në temat gjithëpërfshirëse dhe pastaj janë përshkruar shkurtimisht më poshtë.

### Roli i familjeve në përpjekjet rehabilituese

- Në BdheH nuk është zhvilluar asnjë proces gjyqësor kundër grave të kthyer nga Siria apo Iraku. Prandaj, zgjidhjet që lidhen me rehabilitimin dhe riintegrimin e tyre në shoqëri duhet të gjenden jashtë sistemit të kujdestarisë, në shoqërinë civile.
- Në përgjithësi, qasja e ndjekur nga BdheH në pranimin e të kthyerve karakterizohet nga një zhvendosje nga termi *deradikalizim* në termin e përdorur aktualisht *rehabilitim psikosocial*. Për shkak të luftës që shpërtheu në BdheH në vitin 1992, praktikuesit janë shumë të aftë kur bëhet fjalë për të punuar me qasje të mbështetura me fakte për traumat. Këto aftësi përdoren kur punohet me familjet e lëna pas.
- Qasja e BdheH është në një farë mënyre e krahasueshme me qasjen holistike që aplikohet në Finlandë. Atje, praktikuesit përpiqen të identifikojnë nevojat themelore, vlerat, ankesat dhe dhimbjen e klientit, ndërsa përpiqen të shmangin fokusimin e tepërt në të kaluarën e tyre ekstremiste. Preferenca është të mos flitet për deradikalizim, por për përfshirje, kështu që perspektiva është pozitive dhe e orientuar drejt së ardhmes.
- Në BdheH, gratë e kthyer përgjithësisht ende perceptohen ekskluzivisht si viktime, ndërsa ato, në fakt, mund të kenë pasur role vendimtare brenda DAESH-it, lidhur me gjithçka, duke filluar nga mbështetja logjistike e deri te puna morale policore, duke i mbështetur në mënyrë aktive ose pasive mizoritë e kryera. Përkundrazi, në Kosovë, ku gratë e kthyer gjithashtu nuk ndiqen penalisht, gratë i nënshtrohen mbikëqyrjes në përputhje me Kodin Penal për shkak se kanë shkuar në Siri ose Irak.
- Familjet luajnë një rol specifik në strukturën shoqërore të rajonit dhe në kontekstin e rehabilitimit të BdheH, si dhe në vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor. Në BdheH, femrat e kthyer dhe fëmijët e tyre vendosen në familjet e tyre të origjinës pas kthimit të tyre. Kjo praktikë ka disa avantazhe, por edhe disavantazhe. Një nga avantazhet kryesore është se familjet mund t'i bindin të kthyerit të marrin pjesë në programet e rehabilitimit dhe në këtë mënyrë të mbështesin punën e praktikuesve. Një nga disavantazhet është se praktikuesit duhet të punojnë me shumë klientë, gjegjësisht me të gjithë familjen.
- Si të kthyerit ashtu edhe familjet e tyre kanë nevojë të veçanta psikosociale dhe ekonomike. Për praktikuesit e linjës së parë, puna me këto grupe të synuara kërkon ndërgjegjësimin dhe kuptimin e gjendjes psikologjike të krijuar nga përvojat e grave dhe të fëmijëve të tyre gjatë kohës së qëndrimit të tyre në Siri ose Irak.
- Gjatë kontaktit të parë ndërmjet të kthyerve dhe anëtarëve të familjes së tyre, ndihma e praktikuesve të linjës së parë është shumë e dëshirueshme.
- Procesi i rehabilitimit ka të ngjarë të ketë një shans më të madh për të pasur sukses kur familjet dhe të kthyerit arrijnë të diskutojnë së bashku çështjet e mëposhtme.
  - Pse i kthyeri u largua në radhë të parë. Kjo mund të lidhet me një sërë faktorësh, duke përfshirë qëndrimet e ndryshme ndaj fesë brenda rrethit të tyre të afërt, rënien në dashuri, abuzimin në familje ose alkoolin, sëmundjet mendore, etj.
  - Çfarë mund të ketë përjetuar anëtari i familjes që kthehet, duke përfshirë kthimin me fëmijë ndoshta të padëshiruar nga martesat e detyruara dhe përdhunimet e mundshme.

- Për të qenë në gjendje të zhvillojnë biseda të tilla të vështira, familjet duhet të fuqizohen për të kuptuar nevojat fetare dhe traumat. Për praktikuesit, kjo kërkon vëzhgim të marrëdhënieve dhe të dinamikës familjare, si dhe të emocioneve.
  - Një vlerësim gjithëpërfshirës i situatës familjare është gjithashtu në interesin më të mirë të fëmijëve të kthyer. Kjo mund të përfshijë vendosjen e kontaktit me gjyshërit dhe gjyshet nga të dyja palët, e kështu edhe me familjen e babait të fëmijës.
- Reagimet ndaj kthimit të anëtarëve të familjes mund të ndryshojnë. Familjet mund të kenë përjetuar stigmatizim që nga largimi i anëtarit të familjes së tyre në Siri ose Irak. Ka të ngjarë të kenë përjetuar trauma dhe të jenë ndjerë të turpëruar.
- Ndërsa familjet duhet të konsiderohen si një burim gjatë rehabilitimit, në raste të rralla, familjet mund të përbëjnë gjithashtu një faktor në procesin e radikalizimit të anëtarëve të familjes që janë larguar, duke ndarë dhe inkurajuar ideologjinë e dhunshme.
- Mundësitë që lejojnë pavarësinë financiare dhe sigurimin vetjak të mjeteve për jetesë janë faktorë vendimtarë kur bëhet fjalë për suksesin e përpjekjeve rehabilituese. Megjithatë, situata ekonomike në BdheH paraqet sfida për të kthyerit në këtë drejtim. Përpjekjet e Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin (IOM) tregojnë se përfshirja e komuniteteve lokale mund të forcojë në aspekt social dhe ekonomik, si të kthyerit ashtu edhe komunitetin e tyre lokal, gjë që rrit shanset për shkëputje të qëndrueshme. Për këtë qëllim, IOM promovon dialogun lokal për të frymëzuar diskutimin rreth nevojave të komunitetit.
- U theksua se janë vënë re vështirësi si për familjet ashtu edhe për të kthyerit në marrjen e përgjegjësisë për veprimet e tyre. Veçanërisht në rastet kur nuk ka ndjekje penale, ka pak stimuj në dispozicion për t'i mbajtur të kthyerit përgjegjës dhe për t'i bërë ata të reflektojnë për veprimet e tyre.
- Punonjësit socialë të cilët fillimisht kishin frikë të punonin me të kthyerit për shkak të raportimit të medias që mbjellin frikë dhe refuzimit të përgjithshëm të shoqërisë, thuhet se zhvilluan ndjeshmëri përmes kontaktit të drejtpërdrejtë. Ata theksuan nevojën për të trajtuar paragjykimet personale dhe stigmatizimin.

## Puna me familjet në kontekstin e lirit nga burgu

- Në BdheH, deri më tani, 33 meshkuj të kthyer janë dënuar me burgim nga 2 deri në 3 vjet. Aktualisht, 8 kundërvajtës të dhunshëm ekstremistë dhe terroristë (KDHEH) janë në paraburgim në BdheH.
- Riintegrimi është aktualisht një temë urgjente, pasi nuk ka shërbim sprovues, nuk ka detyrim për të raportuar diku ose për të marrë pjesë në ndonjë lloj programi pas lirit nga burgu. Nevojitet më shumë vazhdimësi e kujdesit.
- Familjet mund të luajnë një rol kyç në procesin e rehabilitimit. Megjithëse aktualisht nuk janë fare të pranishme në kontekstin e burgut, idetë e mëposhtme mund të rrisin përfshirjen e tyre.
  - Para lirit, në burg mund të sillen një menaxher rasti nga Qendra e Mirëqenies (Punës) Sociale, i cili do të jetë në kontakt si me KDHEH-të ashtu edhe me familjen.
  - Të drejta shtesë për vizitë për anëtarët e familjes dhe mundësia për t'u larguar përkohësisht nga burgu si privilegj dhe/ose përfitim për shkak të sjelljes së mirë.
  - Përgatitja e familjeve për të shfrytëzuar këtë kohë të kaluar së bashku për të ndikuar pozitivisht mbi KDHEH-të dhe për t'u përfshirë në mënyrë aktive në rehabilitimin e tyre.

## Rekomandime

- Pavarësisht nga situata e çdo të kthyeri të veçantë, duhet të vendosen kontakte me të gjitha familjet që kanë pasur një anëtar të larguar, në mënyrë që të vlerësohet situata e tyre dhe të identifikohen nevojat e tyre. Për këtë nevojiten qasje të individualizuara.

- Familjet duhet të përfshihen aktivisht në përgatitjen e të kthyerve për lirim nga paraburgimi duke i përfshirë në programin e rehabilitimit përpara lirimit. Si parakusht, familjet kanë nevojë për mbështetje duke u siguruar që financat e tyre janë të mjaftueshme për të pranuar anëtarin e kthyer të familjes.
- Punonjësit social që punojnë me familjet, si dhe me të kthyerit, duhet të zgjidhen dhe të trajnohen me kujdes. Shkëmbimi i përvojave me kolegët që kanë punuar tashmë me grupin e synuar është dëshmuar i dobishëm, në mënyrë që të kapërcehet ngurrimi fillestar për të punuar me ta.
- Kur punohet me gratë e kthyer, ka rezultuar e suksesshme të ngjallen kujtimet se kush ishin ato para se të largoheshin dhe të bëhen përpjekje për të rivendosur kontaktet sociale përtej familjes, për shembull duke gjetur dikë me të cilin kanë qenë të afërta para se të largoheshin për të shërbyer si aleat gjatë rehabilitimit. Grupet për vetë-ndihmë për gratë mund të jenë një tjetër mundësi që duhet të merret parasysh seriozisht.
- Siguria e fëmijëve që mund të kthehen së bashku me KDHE-të duhet të përgatitet me kujdes nëpërmjet përfshirjes aktive, për shembull, të gjyshërve dhe gjysheve ose anëtarëve të familjes, si pjesë e kujdestarisë ligjore që duhet të zbatohet në momentin që prindërit rihyjnë në vend.

## Praktikat përkatëse

Në Kosovë, ku niveli komunal është përgjegjës për riintegrimin e grave të kthyer jashtë sistemit të kujdestarisë, Qendra për Mirëqenie Sociale në Komunën e Prishtinës përfshin OJQ-të për të ndihmuar dhe mbështetur riintegrimin e qëndrueshëm, për të ofruar trajnime profesionale për punësim; për të financuar hapjen e bizneseve; për të siguruar akses në kurset e gjuhës dhe arsimimin plotësues; për të ndihmuar në (ri)ndërtimin dhe rinovimin e banesave; dhe për ndihmë sociale.

Qendra e Mirëqenies Sociale në Sarajevë zbaton një qasje në punën e saj me gratë e kthyer me të cilën përpiqet të zhvendosë strategjinë nga deradikalizimi drejt përfshirjes. Kjo përfshin fuqizimin e tyre ekonomik, shkuarjen e rregullt të fëmijëve në shkollë dhe marrjen pjesë në aktivitete jashtëshkollore, si dhe bashkëpunimin me Bashkësinë islame për të rritur pranimin e të kthyerve te komuniteti lokal.

IOM në BdeH ofron mbështetje të shumëllojshme për menaxhimin e kthimit, duke përfshirë një fond riintegrimi për komunitetin, si dhe mbikëqyrje dhe trajnim për praktikuesit që punojnë me të kthyerit, duke përfshirë edhe me fëmijët.

## Aktivitetet e mëtejshme

Aktivitetet e mundshme vijuese në Ballkanin Perëndimor që dalin nga ky takim, mund të përfshijnë trajnime për punë sociale multidisiplinare, si në shoqërinë civile ashtu edhe në mjediset e kujdestarisë.

## Materiale për lexim

1. RNR (2022) [Manual për reagimet ndaj luftëtarëve të huaj terroristë të kthyer dhe familjeve të tyre](#)
2. Bytyqi, K., Hasanović, M. dhe Pereshin, A. (2021). Femrat e kthyer nga Siria në Ballkanin Perëndimor: Mes keqardhjes dhe 'nostalgjisë për kalifatin'. PERSPEKTIVAT MBI TERRORIZMIN Vëllimi 15, numri 5
3. RNR (2021) [Reagimet me ndjeshmëri gjinore ndaj të kthyerve nga organizatat e huaja terroriste: njohuri për praktikuesit](#)

